Nr/Br. 43/23
Datë/Datum. 28.04.23
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

Psh. nr. 43/23

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej Kimete Gashi - Kryetare, Agon Ramandani - Anëtar, Vedat Poterqoi- Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik OE "Progres L.L.C" – Çikatovë e Re, Gllogoc, me numër protokolli 43/23, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Rregullimi i kanalizimit në rrugën Naim Frashëri" me nr. të prokurimit 656-22-13971-5-2-1, inicuar nga AK – Komuna Ferizaj, më datën 28.04.2023, mori këtë:

V E N D I M

1. Refuzohet si e pa bazuar ankesa e operatorit ekonomik: "Progres L.L.C" - Çikatovë e Re, Gllogoc me numër protokolli 43/23, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Rregullimi i kanalizimit në rrugën Naim Frashëri" me nr. të prokurimit 656-22-13971-5-2-1, inicuar nga AK – Komuna Ferizaj.

2. Mbetet në fuqi B58-Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues i datës 05.01.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Rregullimi i kanalizimit në rrugën Naim Frashëri" me nr. të prokurimit 656-22-13971-5-2-1, inicuar nga AK – Komuna Ferizaj.

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet të informoj me shkrim Panelin Shqyrtues të OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, të precizuar me numër dhe datë si në paragrafët paraprak të dispozitiv të këtij vendimi.

4. Meqenëse ankesa e operatorit ekonomik ankues "Progres L.L.C" – Çikatovë e Re, Gllogoc, refuzohet si e pa bazuar, ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Komuna Ferizaj në cilësinë e autoritetit kontraktues me datë 05.01.2023 ka publikuar Njoftimin për dhënie të kontratës-B85 për aktivitetin e prokurimit "Rregullimi i kanalizimit në rrugën Naim Frashëri" me nr. të prokurimit 656-22-13971-5-2-1, ku është rekomanduar për kontratë OE "Berisha Company" SH.A.

Me datë 10.01.2023, OE ankues "Progres L.L.C" – Çikatovë e Re, Gllogoc, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim tek AK-Komuna Ferizaj. Me datë AK-Komuna Ferizaj 12.01.2023 ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim.
I pakënaqur me vendimin e AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim OE ankues "Progres L.L.C" – Çikatovë e Re, Gllogoc ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër protokolli 43/23.

Autoriteti Kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës - punë, vlera e parashikuar e kontratës: 170,000.00€, në kohëzgjatje prej 36 muaj.

Me rastin e shqyrtimit paraprak, Paneli Shqyrtues konstatoi se, ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë në OSHP vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesi e ka statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse po ashtu ankesat përmbajnë elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe bien nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

-Vlerësimi dhe administrimi i provave-

OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me datë 02.02.2023 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues "Progres L.L.C" – Gllogoc

Përgjigje në pretendimin ankimor nr.1

Eksperti shqyrtues, pas analizimit të dokumentacionit i cili është pjesë e këtij aktiviteti të prokurimit dhe pretendimeve ankimore të parashtruara nga Operatori Ekonomik Progres L.L.C Çikatovë e Re Gllogoc, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Rregullimi i kanalizimit në rrugën Naim Frashëri" me nr. të prokurimit: 656-22-13971-5-2-1 së AK gjatë vlerësimit ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve nuk ka respektuar Kriteret e vendosura në Njoftimin për Kontratë dhe Dosje të Tenderit (FTD) Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pika 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional, me pretendim se Operatori Ekonomik Progres L.L.C Çikatovë e Re Gllogoc i ka plotësuar kriteret e vendosura nga AK në Njoftimin për Kontratë dhe Dosje të Tenderit, sqaroj me sa vijon:
Operatori ekonomik ankues së bashku me ofertën ka dorëzuar listën e pajisjeve pas analizimit të dokumentacionit të prezantuara (te lista e pajisjeve nr.9 keni ofruar si përshkrim dy freza hidraulike) njëra e marrë në shfrytëzim me marrëveshje huazimi nga Hoxha Kom SH.P.K e cila sipas DUD-it është Frezë për gërryerje të asfaltit, e cila nuk është sipas kritereve të AK-së dhe tjetra e marr me kontratë huapërdorje e marrë nga "INFO METAL PLAST-AL" e cila sipas DUD-it Frezë e përdoruar pa specifikuar për çka në këtë rast mund të shërbej.
Ndërsa freza për gërryerje të asfaltit është makineri (pajisje) e cila nuk është në harmoni me kriteret e vendosura në Njoftim për Kontratë dhe Dosje të Tenderit si e tillë nuk plotëson kriteret e AK-së dhe nuk mund të kryejnë funksionet e njëra tjetrës dhe nuk mund të kërkohen sqarime shtesë sepse dokumentet e paraqitura janë të qarta dhe nuk ka të arsyeshme AK të kërkoj sqarime. Mbi këtë konstatoj që ky pretendim ankimor i OE-së ankues PROGRES L.L.C është i paqëndrueshëm dhe si i tillë refuzohet si i pabazuar.

Përgjigje në pretendimin ankimor nr.2

Eksperti shqyrtues, pas analizimit të dokumentacionit i cili është pjesë e këtij aktiviteti të prokurimit dhe pretendimeve ankimore të parashtruar nga Operatori Ekonomik PROGRES L.L.C Çikatovë e Re Gllogoc, i cili pretendon se AK nuk ka respektuar Kriteret e vendosura në Njoftimi për Kontratë dhe Dosje të Tenderit FTD Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pika 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional, me pretendim se OE i rekomanduar fitues nga AK nuk ka plotësuar kriteret sqaroj me sa vijon:

Operatori ekonomik i rekomanduar fitues, së bashku me ofertën ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin sipas kërkesave të AK-së:

Për inxhinierin e gjeodezisë z. Florent Emini së bashku me diplomën është bashkëngjitur edhe vendimi i nostrifikimit të diplomës i lëshuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit me datën 30/12/2012 Ref.Nr.216/246, Licenca si dhe për z. Agim Hajredini është prezantuar diploma në gjuhën serbo kroate e vitit 1994, e vërtetuar dhe protokolluar në atë

kohë, gjithashtu për kërkesën për një punëtor ISO 9001-2015 për të njëjtin është ofruar certifikuar sipas kërkesës së AK-së citat "Një punëtor të certifikuar për me ISO 9001 2015" ku për këtë keni marrë edhe përgjigjen nga kompania që ka lëshuar certifikatën (në këtë rast nuk ka pas asnjë kërkesë më të detajuar se si duhej të ishte certifikata ISO 9001-2015).

Në listën e makinerisë të ofruar nga OE i shpallur fitues janë të prezantuar tri Freza (nr. rendor në listë 17, 18 dhe 33) prej të cilave në bazë të dokumentacionit të dëshmuara me DUD doganorë dy janë në pronësi të OE-së fitues dhe për një është ofruar marrëveshje me Infra plus SH.P.K e cila marrëveshje nuk është e noterizuar sipas kërkesës të parashtruar: kriteri citat "frez hidraulike që vendoset me eksavator për grryerjen e kanalit 2 cope". *"Marrëveshja duhet të jetë në emër të këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët dhe e noterizuar"* e cila nuk ka qen e nevojshme apo nuk ka rendësi në këtë rast sepse OE i shpallur fitues ka plotësuar kriteret e AK-së, të cilat janë vendosura në Njoftimi për Kontratë dhe Dosje të Tenderit duke prezantuar dy copa në pronësi të OE si dhe janë sipas kërkesës së AK.
Mbi këtë konstatoj që ky pretendim ankimor i OE ankues PROGRES L.L.C është i paqëndrueshëm si i tillë dhe refuzohet si i pa bazuar.

Përgjigje në pretendimin ankimor nr.3

Eksperti shqyrtues, pas analizimit të dokumentacionit i cili është pjesë e këtij aktiviteti të prokurimit dhe pretendimeve ankimore të parashtruar nga Operatori Ekonomik ankues për Operatorin Ekonomik Arlindi SHPK konstatoj se i njëjti nuk ka dorëzuar fare Sigurimin e Tenderit i cili ka qen kriter i vendosur nga AK, çështje e cila sqarohet me nenin 28.13 të RRPP-së 001/2022 "Sigurimi i tenderit duhet të dorëzohet i skanuar së bashku me ofertë, ndërsa forma origjinale e sigurimit të tenderit do të kërkohet të dorëzohet nga një tenderues të cilin autoriteti kontraktues ka për qëllim që ta shpërblej me kontratë. Mos dorëzimi i formës origjinale të sigurimit të tenderit shpije në zbatimin e nenit 99.2 të LPP-së" dhe Neni 38 dhe 40.6 të RRPP-së 001/2022. Pra është kërkesë administrative kalon/nuk kalon dhe kjo është kërkesë e cila nuk mund të sqarohet apo plotësohet përmes sqarimeve andaj edhe AK nuk ka pas nevojë të analizoj më tepër këtë ofertë sepse në fund të fundit rezultati do të ishte i njëjtë, pra do të eliminohej.
Mbi këtë konstatoj që ky pretendim ankimor i OE ankues PROGRES L.L.C është i paqëndrueshëm si i tillë dhe refuzohet si i pa bazuar.

Mbështetur nga elaborimet e lart përmendura Autoritetin Kontraktues-Komuna Ferizaj, komisioni i vlerësimit dhe ZPP, ka vepruar në përgjithësi në përputhje me LPP-në, Neni 7 Barazia në Trajtim/Jo diskriminim, ka trajtuar në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim të gjithë OE ofertuese në harmoni të plotë me neni 59 Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, Neni 40 të RRPP-së 001/2022 Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve.

Nga shqyrtimi i kësaj ankese, provat e bashkëngjitur, pretendimet e dispozitave ligjore të shkelura, kërkesat e vendosura në Njoftimin për Kontratë, Dosjes së Tenderit, B54 Formularin

standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet, Raporti i komisionit të vlerësimit, Vendimet në Kërkesat për Rishqyrtim konsiderojmë se pretendimet ankimore të OE-së ankues janë të paqëndrueshme dhe si të tilla refuzohen si të pa bazuara.

Mendimi i ekspertit shqyrtues
Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që
-Ankesa e Operatorit Ekonomik PROGRES L.L.C Çikatovë e Re Gllogoc të refuzohet si e pa bazuar dhe
-Të mbetet në fuqi Formulari B58-Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues i datës 05.01.2023.

-Seanca dëgjimore-

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1 i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtresat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor.

Paneli shqyrtues pasi shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, diskutimit dhe analizimit të provave në tërësi vlerëson se ankesa e Operatorit ekonomik ankues të refuzohet si e pa bazuar dhe të mbetet në fuqi B58-Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues i datës 05.01.2023 dhe Autoriteti Kontraktues të vazhdoj me procedurën duke respektuar në tërësi dispozitat ligjore të LPP-së.

- Përfundim -

Duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, sipas dispozitave të neneve 98, 99, lidhur me nenin 104 dhe 105, të Ligjit të cituar dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, autorizimeve, veprimeve dhe synimeve të AK, Paneli Shqyrtues konstaton se: paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, vlerëson se ankesa është e pabazuar dhe se gjetjet e ekspertit shqyrtues janë të pranueshme nga ana e panelit shqyrtues të OSHP-së.

Nisur nga shpjegimet si më sipër Paneli konsideron se AK ka vepruar në harmoni me dispozitat e cituara si më sipër të LPP dhe ka zbatuar drejtë dosjen e tenderit sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 27, sipas të cilit, autoriteti kontraktues përpilon dosjen e tenderit me të gjitha informatat përkatëse përfshirë të gjitha termet dhe kushtet materiale të saj, procedurat e zbatueshme të prokurimit, çfarëdo kërkese të aplikueshme të përshtatshmërisë ose ndonjë kriter të përzgjedhjes, procedurat e ankesës si dhe informatat e tjera përkatëse siç kërkohen nga ky ligj

ose siç i sheh të domosdoshme autoriteti kontraktues. Paneli shqyrtues vlerëson se AK ka vepruar në harmoni me nenin 59 të LPP-së gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Ndonëse në raportin e ekspertit janë të trajtuara të gjitha pretendimet ankimore, Paneli sipas mendimit të pavarur të tij e ka mbështetur raportin e ekspertit në rastin konkret, nisur nga parimi se vlera provuese e tij jepet gjithnjë me raport me vlerësimin, krahasimin dhe administrimin e të gjitha provave tjera dhe natyrën e një çështje në rastin konkret.

Paneli shqyrtues konsideron se vendimi i marrur në ketë çështje është i bazuar në administrimin e të gjitha provave, në dispozicion të kësaj lënde dhe se në marrjen e vendimeve gjithmonë ka parasysh nenin 1 të LPP-së, ku qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese. Paneli Shqyrtues niset gjithnjë nga fakti se autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në detyrimin e tyre eksplicit respektimi i ligjshmërisë në procesin e prokurimit.

Prandaj Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetarja e Panelit Shqyrtues
Kimete Gashi

Këshillë juridike:
Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale- Dhoma e shkallës së parë, departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:
1x1 AK- Komuna Ferizaj
1x1 OE - ankues "PROGRES L.L.C" Çikatovë e Re Gllogoc
1x1 Arkivës së OSHP-së;
1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së